



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
NJËSIA E PROKURIMIT

Ballsh, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit:

“Blerje Eskavator me Goma”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 43262100-8 Eskavator mekanikë,

Vlera e fondit limit:

7.933.333 (shtatë milion e nëntëqind e tridhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenet 26, 29 dhe 30, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 82 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenet 26 dhe 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Kërkesa për paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të përshtatshmërisë për të kryer veprimtarinë profesionale ka për qëllim garantimin që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik janë të ligjshëm, të aftë dhe të besueshëm për realizimin e kontratës. Nëpërmjet këtij vetëdeklarimi, operatori ekonomik konfirmon ushtrimin e veprimtarisë në përputhje me objektin e kontratës, disponimin e kapaciteteve të nevojshme profesionale dhe ligjore, si dhe mungesën e shkaqeve të përjashtimit. Kjo kërkesë lehtëson procesin e vlerësimit, rrit transparencën dhe përgjegjshmërinë e ofertuesve dhe kontribuon në sigurimin e konkurrencës së ndershme dhe mbrojtjen e interesit publik.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vertetim për xhiron vjetore të tre viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025), lëshuar nga Administrata Tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

***Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe në pikën 1, 2 dhe 3, të nenit 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar më sipër, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2026 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësive të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësia/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe 2, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter mbështetet edhe në legjislacionin e fushës, konkretisht, në përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe në nenet 2, 4 dhe 40, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri synohet të vërtetohet që Operatori Ekonomik ofertues, e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me kuadrin rregullator dhe duke përmbushur në mënyrë korrekte detyrimet që burojnë sipas legjislacionit të fushës, pasi të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtar kanë detyrim të regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, për të bërë të identifikueshme vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshkruar pagesës së taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga ky legjislacion.

2.3 Kapaciteti teknik :

Lidhur me kapacitetet/aftësinë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme të suksesshme, kërkohen dëshmi për mallra të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme, Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentat si vijon:

- a. Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe mallrat e realizuara, ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

ose

- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën e kërkuar, vlerë e cila është jo më shumë se 20% të vlerës së fondit limit. Në përcaktimin e vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme, është mbajtur në konsideratë fakti që vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet, është nën kufirin e ulët monetar. Vlera e kërkuar për furnizimet e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj dhe shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor për të njohur gjendjen dhe kapacitetet e Operatorëve Ekonomikë ofertues, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është një element i rëndësishëm që garanton Autoritetin Kontraktor, se Operatorët Ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Kjo kërkesë është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit dhe njëkohësisht është brenda periudhës dhe vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik ekonomik duhet të paraqesë deklaratë garancie për eskavatorin me goma, ku të jetë përcaktuar periudha e garancisë 1 (një) vit nga data e marrjes në dorëzim nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Kriteri për paraqitjen e një deklarate garancie për eskavatorin me goma, për një periudhë prej të paktën 1 (një) vit nga data e marrjes në dorëzim, përcaktohet duke marrë në konsideratë natyrën, funksionin dhe përdorimin e mjetit objekt prokurimi. Eskavatori me goma është një makineri e rëndë dhe e specializuar, e përbërë nga sisteme

mekanike, hidraulike dhe elektrike, e cila do të përdoret për realizimin e punimeve të Autoritetit Kontraktor. Për shkak të natyrës së tij dhe përdorimit të vazhdueshëm, është e nevojshme që Autoriteti Kontraktor të ketë garanci për funksionimin dhe performancën e mjetit gjatë një periudhe të arsyeshme pas marrjes në dorëzim. Përcaktimi i periudhës së garancisë prej 1 (një) viti synon të mbrojë interesat e Autoritetit Kontraktor nga defektet e mundshme që mund të shfaqen gjatë përdorimit të mjetit dhe të sigurojë që eskavatori të jetë në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues.

Kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, është proporcionale me natyrën dhe vlerën e pajisjes dhe nuk përcakton markë, model, prodhues apo origjinë të veçantë. Për rrjedhojë, ajo nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garantimin e cilësisë, funksionalitetit dhe qëndrueshmërisë së eskavatorit me goma të furnizuar.

Prandaj, kërkesa për një periudhë garancie prej të paktën 1 viti konsiderohet e nevojshme dhe e arsyeshme për sigurimin e funksionimit normal të mjetit dhe mbrojtjen e interesit të Autoritetit Kontraktor.

2.3.3 Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojnë se nëse shpallen fitues do të mbulojnë të gjitha shpenzimet për kalimin e pronësisë së mjetit në emër të Bashkisë Mallkastër si dhe detyrimet që ka mjeti.

Argumentim: Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 8 të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Ky kriter vendoset me qëllim garantimin e përfundimit të plotë të procesit të kalimit të pronësisë së mjetit në emër të Bashkisë Mallkastër, pas shpalljes së operatorit ekonomik fitues. Përfshirja e këtij detyrimi siguron që të gjitha shpenzimet, tarifat dhe detyrimet që lidhen me procedurat e kalimit dhe regjistrimit të pronësisë, sipas legjislacionit në fuqi, të përballohen nga operatori ekonomik fitues dhe të mos krijojnë kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor. Kriteri është i nevojshëm edhe për të garantuar që mjeti objekt i kontratës të dorëzohet me dokumentacionin përkatës dhe me pronësinë e kaluar në mënyrë të rregullt në emër të Bashkisë Mallkastër. Në këtë mënyrë shmangen problematikat administrative apo financiare që mund të lindin pas dorëzimit të mjetit dhe sigurohet përdorimi i tij i ligjshëm nga Autoriteti Kontraktor. Kriteri synon të garantojë realizimin e plotë të objektit të prokurimit dhe shmangien e kostove të paparashikuara nga AK Bashkia Mallkastër.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Komisioni, gjatë hartimit të specifikimeve teknike për blerjen e eskavatorit me goma, është bazuar në nevojat konkrete të Autoritetit Kontraktor për realizimin e punimeve të gërmimit,

sistemimit, mirëmbajtjes së kanaleve dytësore, krijimin e brezave të sigurisë, pastrim rrugësh në masive pyjore, ullishte dhe ndërhyrjeve emergjente që do të dalin në territorin e bashkisë.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me **nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"** i ndryshuar, si dhe **nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"** i ndryshuar, duke garantuar konkurrencë të hapur, trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim të operatorëve ekonomikë. Kërkesat janë përcaktuar në formën e parametrave minimalë teknikë dhe funksionalë, pa favorizuar një markë, prodhues apo model të caktuar.

Konkretisht:

- viti i prodhimit **jo më herët se 2015** dhe **jo më shumë se 8.000 orë pune** janë kërkuar për të siguruar jetëgjatësi, besueshmëri dhe ulje të kostove të mirëmbajtjes;
- pesha minimale **13.000 kg** dhe fuqia minimale **130 HP** janë të domosdoshme për realizimin e punimeve të rënda të gërmimit dhe ngarkimit;
- transmissioni hidrostatik 4x4, sistemi i kondicionimit, dritat e punës, këmbët mbështetëse, gomat në gjendje të mirë dhe pajisjet ndihmëse (thika niveluese, kovë pune, kovë skarpati dhe linja për çekiç) janë kërkesa funksionale që garantojnë siguri, efikasitet dhe kryerjen e të gjitha proceseve të punës për të cilat do të përdoret mjeti;
- kërkesat që mjeti të mos ketë deformime, dëmtime strukturore, xhama të thyer apo pasqyra të dëmtuara synojnë garantimin e sigurisë në punë dhe funksionimin normal të pajisjes.

Përcaktimi i këtyre specifikimeve nuk kufizon konkurrencën, pasi ato mund të plotësohen nga një numër i konsiderueshëm operatorësh ekonomikë që tregtojnë mjete me karakteristika të ngjashme, duke siguruar njëkohësisht që Autoriteti Kontraktor të furnizohet me një mjet funksional, të sigurt dhe të përshtatshëm për nevojat e tij.

Specifikimet teknike janë pjese e DST-ve.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente

Afati i Ekzekutimit: 45 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

NJËSIA E PROKURIMIT